

FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ProCredit Bank eshte pjese e grupit nderkombetar me te njeitin emer. Banka ProCredit eshte e mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrueshmerine tone.

Qendrueshmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit.

I. Objekti i fteses per oferte

Banka ProCredit Shqiperi eshte e interesuar per sigurimin si me poshte:

- a. Aktive fikse te ProCredit Bank sh.a
- b. Aktive te tjera ne pronesi te Bankes
- c. Cash-in ne njesite e biznesit, Drop-Box dhe ATM
- d. Cash-in ne levizje
- e. Automjete ne pronesi te bankes
 - ✓ TPL
 - ✓ Kasko e Plote
 - ✓ Certificate Nderkombetare e Sigurimit Motorrik

Kjo Ftese per Oferte perbehet nga:

1	Ftesa per Oferte	5 faqe
2	Aneksi Nr.1	2 faqe
3	Aneksi Nr.2	2 faqe
4	Aneksi Nr.3	2 faqe
5	Aneksi Nr.4	1 faqe
6	Letra Anti Korrupsion	1 faqe
7	Formulari i Ofertes	1 faqe
8	Deklarate mbi gjendjen gjyqesore	1 faqe

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

II. Oferta

Oferta juaj duhet te perbehet nga:

A. Oferta Ligjore, e cila paraqet *Kriteret e Pranimit/Kualifikimit* dhe duhet te paraqitet sipas kërkesave te renditura me poshte.

1. Subjekti duhet te provoje qe eshte i regjistruar ne regjistrin tregtar dhe per kete duhet te paraqese nje kopje te Ekstraktit Historik, te leshuar nga **Qendra Kombetare e Biznesit**.
2. Subjekti duhet te paraqese nje deklarate nga perfaqesuesi i shoqerise i cili deklaron qe subjekti nuk eshte ne proces falimentimi, nuk eshte denuar per shkelje penale, nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional (sipas formes bashkangjitur).
3. Subjekti duhet te paraqese nje dokument qe verteton se subjekti juaj i ka plotesuar dhe shlyer detyrimet fiskale si dhe sigurimet shoqerore, leshuar nga **Administrata Tatimore**.
4. Subjekti duhet te jete licensuar per ushtrim veprimtarie sigurimi, te leshuar nga autoritetet kompetente, ne te cilen te jene te perfshira klasat e e sigurimeve sipas objektit te kesaj Kerkese per Oferte.

Shenim:

- **Dokumentacioni i kerkuar me siper ne pikat 1 dhe 3, duhet te vertetohet permes dokumentave te leshuar jo me pare se tre muaj, nga dita e fundit e dorezimit te ofertes.**
- **Dokumentacioni i kerkuar me siper, duhet te jete origjinal/i njehsuar me origjinalin ose fotokopje.**
- **Ofertuesit te shpallur fitues do t'i kerkohet ky dokumentacion ne origjinal ose i njehsuar me origjinalin (nese dokumentacioni do te sillet fotokopje)**

B. Oferta teknike.

Subjekti juaj, duhet te provoje se disponon **aftesite teknike** per realizimin e sherbimeve te kerkuara, permes dokumentacionit si me poshte:

1. Te provoje kryerjen e sherbimit te se njejtës natyre, te realizuara **gjate 2 (dy) viteve te fundit** te aktivitetit te shoqerise, duke paraqitur:
 - **Kopje te kontratave** per realizimin e sherbimeve te se njejtës natyre dhe/ose **leter reference/vertetim** per kryerjen e sherbimeve.
 - Nje liste te shoqerive/institucioneve per te cilat keni realizuar sherbimet e kerkuara ne kete ftese per oferte, me numra kontakti ne menyre qe te mund te kontaktohen nga ana e bankes.
2. Subjekti juaj duhet te dergoje kontraten e ri-sigurimit me shoqerite e huaja dhe kontrate tip per secilin prej sherbimeve qe do te ofertoni.
3. Duhet te perfshihet ne oferten teknike te gjitha kushtet e sigurimit qe shoqeria juaj aplikon (pjesë e kontratave te sigurimit)
4. Afatin e pergjigjes ne rast aksidenti per sigurimin e automjeteve, vleresim demi/ riparim/ likujdim detyrimesh, te shprehur ne menyre te detyrueshme ne dite pune.
5. Bashke me dokumentacionin duhet te dergohen dhe pasqyrat financiare te 3 (tre) viteve te fundit, bazuar ne raportin e Auditorit te Jashtem, te cilat perfshijne:
6. Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

- Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve;
- Pasqyra e ndryshimeve ne kapital si dhe Struktura e Aksioneve;
- Pasqyra e rrjedhes se parase

7. Subjekti juaj duhet te dergoje nje kopje te certifikatave (ISO 14001/EMAS) Mjedisore & Sociale nese disponon.

8. **Oferta Ekonomike.**

1. Monedha e kuotuar duhet te jete ne Leke perfshire te gjitha detyrimet tatimore. Ne rast se oferta juaj do te jete kuotuar ne monedhe te ndryshme nga ajo e kerkuar ne kete Ftese per Oferte, per reference do te merret kursi i kembimit i Bankes se Shqiperise ne daten e dorezimit te ofertave.
2. Oferta ekonomike do te vleresohet sipas natyres se sigurimit te kerkuar. Shoqeria duhet te respektojë formatin e kesaj Ftese per Oferte ne kuotimin e kerkuar.
3. Oferta juaj do te jete e vlefshme per nje periudhe nje vjeçare dhe duhet te paraqitet sipas udhezimeve te meposhteme:

Primi: Primi duhet te ofrohet sipas llojit te sigurimeve ne anekset perkatese. Ne prim duhet te perfshihen te gjitha detyrimet tatimore.

Shtimi i riskut: Percaktoni koeficientet perkates per secilin lloj sigurimi nese gjate periudhes se siguruar do te kete shtim ose pakesim risku (shtim ose pakesim te asetave fikse, cash-it, etj) si edhe menyren e llogaritjes.

Letra Anti korrupsion dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqesore: Bashkangjitur me ftesen per oferte eshte Letra Antikorrupsion dhe Deklarata mbi Gjendjen Gjyqesore te cilat duhet te dergohen te firmosura dhe vulosura se bashku me oferten tekniko-ligjore.

Formulari i Ofertes: Bashkangjitur me ftesen per oferte eshte Formulari i Ofertes qe duhet te dergohet i firmosur dhe vulosur se bashku me oferten ekonomike.

III. **Dorezimi i Ofertes**

Oferta juaj duhet te jete e ndare ne dy zarfa te ndryshem. Dokumentacioni ligjor dhe teknik duhet te jete ne nje zarf dhe oferta ekonomike ne nje zarf tjetër.

Te dyja keto zarfe te cilat duhet te shenojne qarte se cfare permbajne. Zarfat duhet te jete te vulosur nga shoqeria ne pjesen e ngjitjes se tyre. Ata duhet te kete te shkruar qarte: Siguracion per ProCredit Bank sh.a., si dhe Emrin e Shoqerise qe e dergon. Zarfat duhet te protokollohen prane recepsionit te Zyrate Qendrore te PCB-se dhe Shoqeria duhet te sigurohet qe kjo oferte eshte protokolluar. Per te shmangur cdo paqartesi, kerkojme qe perfaqesuesi i shoqerise te mos largohet nga Zyrat Qendrore te PCB-se pa marre numrat e protokollit te ofertes. Ne total duhet te jene dy numra protokollit.

Ne rast se oferta juaj dorezohet e hapur, me e-mail, fax ose ne ndonje menyre tjeter nga ajo e kerkuar me lart, oferta nuk do te konsiderohet e vlefshme.

Oferta juaj, ne nje zarf te mbyllur dhe te vulosur, ne formatin e kerkuar do te adresohet dhe paraqitet ne:

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Ref: 20200522: Siguracë për Bankën ProCredit
ProCredit Bank sh.a.
Rr. Dritan Hoxha
Tiranë

IV. Vlerësimi i Ofertes

Shoqëritë pjesëmarrëse për sigurimin e Aktiveve fikset dhe Sigurimin e Cash-it do të vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtme:

Kriteret e vlerësimit të ofertes në total.	Pesha specifike
Cilësia	40%
Cmimi	60%

Kriteret e vlerësimit të Cilësise	Pesha specifike
Qëndrueshmëria financiare e shoqërisë	40
Pershtatshmëria e kushteve të ofertes, në linjë me kërkesat dhe nevojat e Bankës	30
Eksperiencën e shoqërisë në treg (nr i klientëve dhe referencat)	10
Përgjegjësitë Sociale & Mjedisore të shoqërisë	10
Eksperiencën e shoqërisë me ProCredit Bank	10

Shoqëritë pjesëmarrëse për sigurimin e automjeteve do të vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtme:

Kriteret e vlerësimit të ofertës në total.	Pesha specifike
Cilësia	20%
Cmimi	80%

Kriteret e vlerësimit të Cilësise	Pesha specifike
Afati i përgjigjes në rast aksidenti (vlerësim dëmi/ riparim/ likuidim detyrues)	40%
Qëndrueshmëria financiare e shoqërisë	30%
Përgjegjësitë Sociale & Mjedisore të shoqërisë	10%
Eksperiencën e shoqërisë në treg (nr i klientëve dhe referencat)	10%
Eksperiencën e shoqërisë me ProCredit Bank	10%

Sqarim:

- Pas shqyrtimit të ofertes tekniko – ligjore, Banka procedon me hapjen e ofertes financiare.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

- Banka do të njoftojë me shkrim nëse jeni perzgjedhur ose jo fitues.
- Shoqëria që do të grumbullojë me shumë pike në përfundim të dy fazave (tekniko-ligjore dhe financiare), do të perzgjidhet nga Banka për të bashkëpunuar për shërbimet e kërkuara objekt të kësaj ftese për oferte.

VI. Afati i dorezimit

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave në Bankë, në adresën e mësipërme është datë **5 Qershor 2020, ora 16.00.**

Për çdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni në: info_procurement@procredit-group.com.

Për çdo ankese në lidhje me vendimin për procesin e prokurimit ju lutemi mos hezitoni t'i adresoni në: albankesaprokurime@procredit-group.com

Ju lutem përcaktoni në ofertën tuaj mënyrën e marrjes së kësaj Ftese për Propozim duke vendosur një kryq për një nga mënyrat e mëposhtme:

- | | |
|--------------------------------|-------|
| a) dërguar me postë nga banka | _____ |
| b) nëpërmjet internetit | _____ |
| c) është tërhequr pranë bankës | _____ |
| d) nga shoqëri të tjera | _____ |

Sinqerisht,

ProCredit Bank sh.a



Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

ANEKSI Nr. 1: Kuotimi per sigurimin e Aseteve fikse

a. Sigurimi i aktiveve fikse

Objekti i sigurimit:

- 1- Pasuri te paluajtshme
- 2- Asete ne progres
- 3- Pajisje Kompjuterike
- 4- Pajisje Energjetike
- 5- Pajisje Elektronike
- 6- Asete te tjera

Tipi i riskut i siguruar:

- Sipas detajimeve te Tabeles me poshte:

Inventari i asetëve fikse për sigurim		
Aktive Fikse	Vlera (Leke)	Klasat e Riskut
Pasuri te paluajtshme (Godina)	371,935,903	Zjarr, Shok elektrik, Permbytyje, Rrjedhje uji, Stuhi, Termet ose Rreshkitje dheu, Pluhur, Temperature/lageshti mjedisi, Lende te djegshme, Demtime fizike te qellimshme ose jo, Vandalizem, Vjedhje, Akt keqdashesh.
Aktive fikse ne progres	10,921,272	
Paisje kompjuterike	42,235,875	
Paisje elektronike	14,587,558	
Paisje elektrike	5,996,930	
Aktive te tjera	15,306,647	
Punime dhe investime ne pronat me qera	5,617,668	
Prona te lena me qera	13,832,614	
Totali	480,434,467	

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

b. Sigurimi i Aktiveve te tjera ne pronesi te bankes

Objekti i sigurimit:

- 1- Toka+Godina
- 2- Godina (Apartament, Garazhd, Lokal, Ndertese Banimi, Ndertese Biznesi)

Tipi i riskut i siguruar:

- Sipas detajimeve te Tabeles me poshte

Aktive te tjera ne pronesi te bankes	Vlera (Leke)	Klasat e Riskut
Toke+Godine	19,377,257	Zjarr, Permbytje, Rrjedhje uji, Stuhi, Termet ose Rreshkitje dheu, Demtime fizike te qellimshme ose jo, Vandalizem
Godine (Apartament, Garazhd, Lokal, Ndertese Banimi, Ndertese Biznesi)	105,936,791	
Totali		

Vlera totale e aktiveve per t'u siguruar ne leke	Primi i sigurimit	Pjesa e zbritshme (ne rast se ka)	Franshize (ne rast se ka)	Koeficientet ne rast shtimi/pakesimi te riskut
605,748,515				

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Sqarim: Ju duhet të kuotoni në tabelën e përcaktuar më lart referuar vlerës totale të aktiveve fikse.

Se bashku me primin duhet të përcaktohet dhe pjesa e zbritshme (nese e aplikoni) dhe koeficienti në rast se aplikohen. Ju lutem të specifikohet qarte cdo kosto shtese (qe nuk eshte paqyruar ne tabelen e mesiperme)

Cdo shoqeri qe aplikon pjese te zbritshme /franshize duhet ta specifikojë qarte ne oferten ekonomike vleren perkatese.

Banka parashikon në fund të çdo 3 mujori do të azhurnojë primin në varesi të ndryshimit të vlerave të aseteve fikse që banka do të sigurojë për shkak të amortizimit, blerjet e reja apo fshirje të aseteve. Ju lutem përcaktoni koeficientin për këtë sigurim për këtë periudhë të azhurmimit të primit.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

ANEKSI Nr. 2: Sigurimi i CASH-it

a. SIGURIMI I CASH-IT NE KASAFORTE

Objekti i sigurimit:

Parate ne kasaforte

Risku i siguruar:

Vjedhja, zjarri, grabitja

Shuma e siguruar per cdo ngjarje:

Deri ne **40,000 USD**

Cash-i ne Banke ndodhet ne:

- kasaforta kryesore, kasafortat ditore dhe ne dhomen e kasafortes kryesore;
- ne pajisjet ATM dhe Drop-Box, te vendosura ne zonat e vetesherbimit 24/7 te Bankes

Primi i sigurimit

Pjesa e zbritshme (nëse ka)

Franshize (nëse ka)

Formula e llogatitjes së tij:

Shenim i rëndësishëm: Kërkesa per Sigurimin e mesiperm nenkupton mbulim per cdo ngjarje te ndodhur pergjate harkut kohor 1 vjecar per cash-in ne kasaforte per banken

b. SIGURIMI I CASH-IT NE TRANZIT (LEVIZJE)

Objekti i sigurimit:

Parate ne udhetim

Risku i siguruar:

Vjedhja, zjarri, grabitja

Shuma e siguruar per cdo ngjarje:

Deri ne **40,000 USD**

Primi i sigurimit

Pjesa e zbritshme (nëse ka)

Franshize (nëse ka)

Formula e llogatitjes së tij:

Shenim i rëndësishëm: Kërkesa per Sigurimin e mesiperm nenkupton mbulim per cdo ngjarje te ndodhur pergjate harkut kohor 1 vjecar per cash-in ne levizje per banken

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Shenim:

Ju lutem percaktoni:

- Koeficientin e primit/ nese ka, nese gjate periudhes nje vjeçare Banka do te hape dege /pika sherbimi/qendra biznesi/ATM off-site te reja. Shpjegoni menyren e perlogaritjes.
- Koeficientin e primit /nese gjate periudhes nje vjeçare banka do te ndryshoje limitet e Cash. Shpjegoni menyren e perlogaritjes.
- Cdo shoqeri qe aplikon pjese te zbritshme / franshize duhet ta specifikojë qarte ne oferten ekonomike vleren perkatese

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

ANEKSI Nr. 3 Specifikime Teknike dhe Oferta Ekonomike per automjetet e bankes

NR	EMERTIM	Data Blerjes	Targa	Vlera e Blerjes (ALL)	Vlera e mbetur (ALL)	Cmimi per TPL	Cmimi per Kasko	Cmimi per siguracion nderkombetar
1	RENAULT CLIO	13/08/2015	AA632NB	2,240,000.00	261,841.23			
2	RENAULT CLIO	13/08/2015	AA634NB	2,240,000.00	261,841.23			
3	AUTOMJET SKODA SUPERB 2.0 TDI DSG	04/04/2016	AA552NS	3,314,640.00	608,589.76			
4	AUTOMJET SKODA SUPERB 2.0 TDI DSG	04/04/2016	AA553NS	3,314,640.00	608,589.76			
5	AUTOMJET SCODA OCTAVIA	17/03/2017	AA430RC	2,099,320.00	804,448.65			
6	AUTOMJET SCODA OCTAVIA	17/03/2017	AA431RC	2,099,320.00	804,448.65			
7	AUTOMJET SCODA OCTAVIA	17/03/2017	AA432RC	2,099,320.00	804,448.65			
8	AUTOMJET E-UP HIGH	03/05/2018	AA058UC	3,172,543.50	1,956,252.21			
9	AUTOMJET E-GOLF	03/05/2018	AA059UC	4,351,537.65	2,683,242.98			
10	AUTOMJET E-GOLF	28/05/2018	AA060UC	4,351,537.65	2,683,242.98			
11	AUTOMJET E-GOLF	28/12/2018	AA102VN	4,313,338.60	3,092,204.31			
12	AUTOMJET E-GOLF	28/12/2018	AA592VL	4,337,870.10	3,109,790.80			
13	AUTOMJET E-GOLF	28/12/2018	AA934VL	4,337,870.10	3,109,790.80			
14	AUTOMJET E-GOLF	28/12/2018	AA963VM	4,313,338.60	3,092,204.31			
15	Automjet CHEVROLET AVEO	27/03/2013	KL1TF48G9DB071820	1,559,000.00	0.00			
16	AUTOMJET TOYOTA YARIS HYBRID	28/05/2015	AA581LU	2,506,000.00	0.00			
17	AUTOMJET TOYOTA YARIS HYBRID	28/05/2015	AA582LU	2,506,000.00	0.00			
18	WOLKSWAGEN MULTIVANTR5084R	15/12/2008	9900005589	3,102,979.74	0.00			
19	RENAULT CLIO	13/08/2015	AA633NB	2,240,000.00	261,841.23			
Shuma					24,142,777.55			

Per keto mjete duhet te ofrohet sherbim Kasko perfshire dhe Kosoven
Vetem per keto mjete jemi te interesuar per siguracion nderkombetar

Sqarim:

- Vlera e mbetur e automjetit eshte perlogaritur sipas sistemit te amortizimit te Bankes.
- Pjesa e zbritshme e demit duhet te perfshihet ne prim per cdo sigurim, si per TPL, Full Kasko dhe ate Nderkombetar.
- Cdo shoqeri qe aplikon franshize duhet ta specifikojte qarte ne oferten ekonomike vleren perkatese.



Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Lutemi percaktoni ne oferten tuaj kerkesat tona si me poshte:

Oferta duhet te perfshije:

1. Per sherbimin e riparimit te automjeteve ne rast aksidentesh opsionet e qendrave te sherbimit ne rast se sugjerohen nga shoqeria juaj do te jene:

- _____
- _____
- _____

Ose ato te identifikuara nga Banka per "sherbimin periodik/riparimin e automjeteve te PCB". Ne rast demtimesh, automjetet mund te riparohen ne serviset e sugjeruara nga ju ose ne serviset e kontraktuara drejperdrejt nga Banka. Ne kete rast (serviset e kontraktuara nga Banka), shoqeria juaj do te demshperbleje demin duke paguar faturen e riparimit.

2. Shoqeria eshte e gatshme te ofroje sherbime shtese, lutem listoni me poshte:

- _____ (karroatrec ne rast aksidenti)
- _____ (zevendesim automjeti gjate periudhes se riparimit)
- _____ (propozime te tjera)

Lutem specifikoni cilat nga sherbimet mesiperme ofrohet me pagese.

3. Afati i dorezimit te policave: Percaktohet nga siguruesi _____ dite kalendarike.
Ne rast vonese ne dorezimin e policave brenda afatit te parashikuar ne Urdher Blerje banka ka te drejte te aplikojte nje gjobe prej 0.5 % te primit per cdo dite vonese.
4. Afati i demshperblimit nga momenti i njoftimit: Percaktohet nga siguruesi _____ dite pune.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Aneksi nr 4: Lista e Njesive te Biznesit

Pershkrimi i Njesive te Biznesit	Adresat
Zyrat Qendrore (Head Office)	Rr. "Dritan Hoxha", Laprake, Tirane
Arkiva Vore	Vore
Njesia e Biznesit Korce	Rr. "Midhi Kostani"
Njesia e Biznesit Shkoder	Lagjia Qemal Stafa, Bulevardi Zogu i Pare
Njesia e Biznesit Tirane	Rr. "Dritan Hoxha", Laprake, Tirane
Zona 24/7 Kombinat	Rr. Lambi Bonata 44, (Shkalla 2 Kombinat, Tirane)
Njesia e Biznesit Piazza	Rr. Ded Gjo Luli, (prane Muzeut Kombetar), Tirane
Njesia e Biznesit Durres	"Lagjia nr. 4, Rruga Egnatia Durres, pallatet Xhemf, kulla nr. 3, kati 0"



Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

FORMULAR OFERTE

[Ofertuesi duhet të plotësojë këtë Formular në përputhje me udhëzimet e treguara. Nuk lejohen ndryshime apo zëvendësime të këtij formati.]

Date: ____/____/____

[plotësoni datën (ditë, muaj, vit) e dorëzimit të ofertes]

Numri i fteses :20190503

Per: **ProCredit Bank**
Departamenti Finances
Tiranë, Shqipëri

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë që:

- (a) Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në këtë procedurë prokurimi dhe pranojmë, pa rezervë ose përjashtime, kërkesat, afatet dhe kushtet e shprehura në to;
- (b) Ne sigurojmë furnizimin në përputhje me Dokumentat e Tenderit, Afatet e Levimit për Mallrat dhe Shërbimet respektive si më poshtë _____ *[plotësoni shkurtimisht mallrat, apo shërbimet respektive];*
- (c) Ne përmbushim gjithë kërkesat ligjore, financiare-ekonomike dhe teknike të specifikuara në dokumentat e tenderit si vërtetohet nga certifikatat dhe dokumentat e dorëzuara me këtë deklaratë
- (d) Cmimi total i Ofertes sone, përfshirë çdo detyrim tatimor është: _____ *[plotësoni cmimin total të ofertes me numra dhe fjalë, si dhe monedhën];*
- (e) Oferta jone do të jetë e vlefshme nga data e dorëzimit të ofertes deri me date.....;
- (f) Nëse oferta jone do të pranohet, ne angazhohemi të mbajmë një garanci kontrate në përputhje me dokumentat e tenderit nëse kjo është e aplikueshme;
- (g) Ne nuk kemi konflikt interesi në përputhje me Letren Antikorrupsion;
- (k) Ne kuptojmë se kjo ofertë, sëbashku me njoftimin tuaj zyrtar të shpalljes së fituesit do të shërbejë si një kontratë e perkohshme ndërmjet nesh, derisa të përgatitet dhe nënshkruhet kontrata zyrtare.
- (l) Ne kuptojmë që nuk jeni të detyruar të pranoni ofertën me cmimin më të ulët ose çdo ofertë tjetër që ju mund të mërmë.

Firmosur: _____



Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Date: _____

Letra Antikorrupsion (Deklarata e Perputhshmerise)

Grupi ProCredit vlereson se ndikimet etike, shoqerore dhe mjedisore jane pjese e rrjetit te furnizimit. Veç kesaj, ndikimet pozitive mund te arrihen permes blerjes se produkteve dhe/ose sherbimeve me te pergjegjshme, si dhe duke punuar bashkerisht me furnitoret per te ndikuar pozitivisht ne performancen etike, shoqerore dhe mjedisore. Ndaj, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve/kontraktoreve te tij qe t'i permbahen nje pakete standardesh minimale per te garantuar pajtueshmerine e angazhimeve te tyre per çeshtjet kryesore shoqerore, mjedisore dhe te administrimit me standardet e larta te ProCredit.

Njesoj siç veprohet me klientet, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve dhe kontraktoreve te tij qe te mos angazhohen ne asnje prej veprimtarive te renditura ne Listen e Perjashtimit te ProCredit. Aktivitetet me te rendesishme, por jo te vetmet, qe permban kjo liste jane:

-Prodhimi ose veprimtarite qe perfshijne forma te demshme ose shfrytezuese te punes se detyruar/punes se demshme per femijet, praktikat diskriminuese ose praktikat qe i pengojne punonjesit te ushtrojne ne menyre te ligjshme te drejtat e tyre te lirise se organizimit dhe te negociimit kolektiv (per hollesi te metejshme, shihni piken a) te Listes se Perjashtimit)

-Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve kombetare, si dhe konventave dhe marreveshjeve nderkombetare per prodhimin dhe/ose tregtimin e çdo produkti apo veprimtarie (per hollesi te metejshme, shihni piken e) te Listes se Perjashtimit)

-Shoqeria konfirmon se nuk kryen aktivite tregtare te gjendura ne listen perjashtimore te ProCredit Grup.

-Duke qene se Grupi ProCredit i permbahet Deklarates Universale per te Drejtat e Njeriut (1948) pret qe te njejten gje te bejne edhe furnitoret dhe kontraktoret e tij. Keshtu, shoqeria tregtare konfirmon se iu permbahet standarteve dhe etikes me te larte te biznesit gjate procesit te tenderit dhe gjate zbatimit te kontrates. Ajo zbaton standartet e Shendetit, Sigurise ne pune, Sigurise Mjedisore dhe standartet e ILO dhe nuk eshte e perfshire ne punen e detyruar ose ne punen e paligjshme te femijeve. Gjithashtu shoqeria konfirmon se nuk eshte e perfshire ne praktika diskriminuese apo praktika qe ndalojne punemarresit e saj per te ushtruar te drejten e tyre ligjore per t'u mbledhur dhe anetaresuar ne organizatat e punemarresve.

-Shoqeria pranon se perfshirja e saj ne nje nga praktikat e paligjshme te permendura me sipër, do te sjelle perjashtimin e saj nga procedura e tenderimit ose nderprerjen e kontrates ne menyre te menjehershme nga ana e ProCredit Bank sha.

- Siç percaktohet ne Kodin e Sjelljes, Grupi ProCredit nuk toleron rastet e pastrimit te parave, mitmarrjes dhe korrupsionit. Prandaj, marredheniet e biznesit nuk mund te krijohen ose te vazhdohen ne rast se mesohet qe nje furnitor potencial eshte i perfshire ne rastet e pastrimit te parave, korrupsionit dhe/ose mashtrimit. Theksohet se Grupi ProCredit nuk pranon rryshfete te asnje forme dhe as nuk pranon angazhimin e furnitoreve ne praktika te tilla.

Furnitoret dhe kontraktoret qe rezultojne te perfshire ne veprimtari te kesaj natyre, do te perjashtohen nga mundesia per t'u bere partnere.

-ProCredit Bank do te refuzoje ofertat pjesemarrrese ne tender, nese deshmohet ose nese konsiderohet se shoqeria eshte e perfshire ne ndonje rast te pastrimit te parave, mashtrimit ose ne raste korrupsioni gjate procesit te tenderit ose do te anulroje kontraten nese deshmohet se ka ndodhur ndonje nga keto raste gjate procesit te dhenies se kontrates.



Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

-Per qellimet e kesaj politike aktivitetet e meposhtme do te konsiderohen si korrupsion:

- a) *Veprimin e te dhenit, pranuarit ose kerkimit te mjeteve te cfaredo vlere, per te ndikuar te ndonje person tjetër juridik, personel te PCB-se ose te ndonje shoqeri tjetër, gjate procesit te tenderimit ose gjate dhenies se kontrates.*
- b) *Demtimit e prones se PCB-se, kercenimin e personelit te PCB-se, kercenimin per demtim te reputacionit te PCB-se ose ndonje shoqerie tjetër per te ndikuar ne procesin e tenderimit ose per zbatimin e kontrates se dhene.*
- c) *Marreveshjen ne mes te dy ose me shume shoqerive per te imponuar ose per te ndikuar ne tenderet e papershtatshem, tendere me çmime artificiale ose çmime jo konkurruese.*
- d) *Falsifikimin e qellimshem, ndryshimin, fshehjen ose paraqitjen e gabuar te informatave te kerkuara ose te paraqitura gjate procesit te tenderit ose gjate zbatimit te kontrates.*

-Per qellimet e kesaj politike veprime te mashtrimit konsiderohen perpjekjet ose pakujdesite e qellimshme per te mashtruar ose perpjekjet per te mashtruar stafin e PCB-se ose shoqerive te tjera, ne menyre indirekte ose te drejtperdrejte, per te perfituar financiarisht ose per t'ju shmangur detyrimeve te percaktuara me kontrate ose me ligj.

Grupi ProCredit pret prej furnitoreve te tij te angazhohen dhe te respektojne ndershterisht standardet e percaktuara ne kete dokument. Furnitoret priten te demonstrojne angazhimin e tyre duke bashkepunuar ngushtesisht me Grupin ProCredit, si dhe duke ofruar akses te arsyeshem ne dokumentacionin/informacionin perkates, nese gjykohet e nevojshme. Ne rastin e shkeljeve te renda dhe/ose te vazhdueshme te standardeve te percaktuara ne kete dokument, Grupi ProCredit do te ndermarre hapat e nevojshem per nderprerjen e marredhenieve te biznesit.

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruessit konfirmojne autoritetin e tyre per te nenshkruar ne emer te furnitorit dhe per t'u angazhuar per respektimin e standardeve te percaktuara ne te.

Deklarata per t'u nenshkruar nga furnitori/kontraktori

Emri i kompanise _____

Numri i regjistrimit _____

Numri i kontrates/tenderit _____

Adresa _____

Data _____

Nenshkrimi i autorizuar _____

Emri _____



Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

DEKLARATE MBI GJENDJEN GJYQESORE

E shoqërise pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Banka ProCredit sh.a. me objekt _____

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të shoqërise _____ deklaroj se:

- Shoqëria _____ nuk është dënuar për shkelje penale,
- Shoqëria _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional,
- Shoqëria _____ nuk është në proces falimentimi

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Perfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

